

FAZA PËRGATITORE E PROCESIT INVESTIV





- Menaxhimi i fazes pergaditore te procesit investiv, perfshin aktivitetet pergatitore te cilat kane te bejne me:
 - Hulumtimin e rrethines
 - Nxerrjen e ideve per investime
 - Venien e tyre ne lidhshmeri me politiken dhe qellimet zhvillimore.



- Faza përgatitore e procesit investiv përfshin :
 - Evidentimin
 - Analizën e ideve
 - Përzgjedhjen e tyre
 - Identifikimin e projekteve
 - Formulimin e alternativave dhe
 - Vlerësimin e tyre.



- Identifikimi i projekteve investive niset prej ideve per investime, ku perfshihen :

- Informatat mbi impulset e tregut

- Poziten e investitorit ne treg

- Zhvillimin teknologjik

- Problemet e perditshme me te cilat ballafaqohet ndermarresi ne afarizem etj.



- Ne hyrje te studimit paraprak investiv duhet te shqyrtohet :

- Zhvillimi i deritanishem i investitorit
- Menyra e afarizmit te tij
- Mundesite dhe potencialet e tij zhvillimore
- Pozita e tij ne treg



- Studimi investiv, ne analizen dhe planifikimin e projektit investiv ne vete perfshin tri pjese kryesore, e qe jane :

- Tregu

- Aspektet tekniko-teknologjike dhe organizative

- Aspektet ekonomiko-financiare



- Analiza e tregut te shitjes, varet nga natyra e produktit dhe cilesise se tij, ku perfshihet :

- Analiza e kerkeses
- Analiza e ofertes
- Analiza e cmimeve
- Prognoza e plasmanit

Analiza e kerkeses



- Te analiza e kerkeses, faktoret kryesor qe ndikojne ne faktorin e kerkeses jane :
 - Faktoret e pergjithshem (popullsia, klima,kursimet..)
 - Faktoret fizik (dizajni, lokacioni, komunikacioni, lidhjet..)
 - Faktoret shoqeror (prestigji, madhsia e familjeve..)
 - Faktoret ekonomik (cmimet, levizja e konsumit,...etj.)

Projeksioni i plasmanit



- Projeksioni i plasmanit ne vete perfshin politiken e plasmanit dhe kanalet e distribuimit , ne baze te analizes dhe projektimit te kerkeses dhe te ofertes mund te behet krahasimi i tyre dhe vlersimi i mundesive te plasmanit me ç'rast kemi keto situata :
 - Oferta agregate = Kerkesen agregate ($O_a = K_a$)
 - Kerkesen agregate > Oferta agregate ($K_a > O_a$)
 - Kerkesen agregate < Oferta agregate ($K_a < O_a$)

VLERËSIMI I EFIKASITETIT TË PROJEKTIT INVESTIV



- Vlerësimi i efikasitetit të projektit investiv paraqet një sintetizim të të dhënave nga i tërë studimi investiv, përpunim të tyre dhe shprehje të tyre nëpërmjet treguesve që e shprehin efikasitetin dhe efektivitetin e projektit investiv.
- Qëllimi final i planeve të investimeve dhe i të gjitha analizave të operacioneve financiare të organizatës është marrja e vendimeve për maksimizimin e vlerës së saj ose vlerës së aktiviteteve të saj financiare. Ky objektivi sigurohet duke u dhënë përgjigje pyetjeve:
 - Si do të zgjedhim midis shumë propozimeve atë që do t'i përjashtojë të tjerët?
 - Cilat projekte duhet të pranohen, në mënyrë që vlera e firmës të jetë maksimale?



- Natyra e projekteve investive është e tillë, që përfitimet dhe shpenzimet e tyre zakonisht ndodhin në periudha të ndryshme kohore.
- Pasiqë një shumë parash e disponueshme tani konsiderohet më e vlefshme se sa e njëjta shumë e pranuar në një periudhë të ardhme, është e nevojshme që t'i japim peshë më të madhe kostove dhe benefiteve që ndodhin më herët dhe peshë më të vogël atyre që ndodhin më vonë.



- Vlera në kohë e parasë është një nga konceptet bazë të financës. Koncepti i vlerës në kohë të parasë ka zbatime të shumta.
- Ai luan një rol të jashtëzakonshëm, sepse mundëson marrjen e investimit më të volitshëm, në kushtet kur vendimet mirren sot, kurse rezultati apo pasojat ndihen pas shumë vitesh.
- Njohja e vlerës në kohë të parasë është kusht i domosdoshëm për të kuptuar procesin e zgjedhjes së investimeve afatgjata.

Llogaritja e kamatws sw thjeshtw



Interesi (kamata) i thjeshtë

$$I = K_0 \frac{p}{100} \cdot n$$

K_0 - Vlera e Tanishme e Kapitalit, i - Norma e interesit,
 n - numri i periudhave

Llogaritja e Interesit (kamatës) për periudha më të shkurta se një vit (muaj, ditë)

$$I = K_0 \left(\frac{p}{100} \cdot \frac{d}{360} \right)$$

p - norma e interesit (kamatës)

d - numri i ditëve për të cilat llogaritet interesi (kamata)



- Shembull:
- Te llogaritet permes interesit te thjeshte, per sa dite duhet te depozitohen 225 euro per tu fituar 500 euro me kamate 18 %

Vlera e ardhshme dhe interesi i përbërë



- Meqë një shumë prej 1€ sot, nëse investohet, do të rritet në $€(1+i)$ në vit, mund të themi se një shumë B vitin e ardhshëm do të ketë vlerën e tanishme të $€B * (1+i)$. Ngjashëm, meqë një investim prej 1€ tani do të rritet në $€(1+i)^n$ pas n-viteve, rrjedh që një shumë B që do ta pranojmë pas n viteve në të ardhmen, do të ketë një vlerë të tanishme prej $€B * (1+i)^n$.
- Sa më e madhe të jetë norma e shfrytëzuar e diskontimit *i*, dhe sa më e largët të jetë koha (data) kur do të realizohet shuma e dhënë, aq më e vogël është vlera e saj e tanishme.



- Nëse keni investuar 100 euro në një llogari bankare. Të themi se banka ju paguan juve një shkallë interesi prej 6 përqind në vit në depozitat tuaja.
- Kështu, pas një viti ju do të fitoni interesin prej 6 eurove:
- *Interesi = shkalla e interesit * investimi fillestar*
*= 0.06 * 100€ = 6€*

- Nëse i mbani paratë tuaja të investuara për tri vite, investimi juaj shumëzohet me 1.06 çdo vit për tri vite radhazi.
- Deri në fund të vitit të tretë do të keni në total: $100\text{€} * (1.06)^3 = 119.10\text{€}$.
- Qartë, për një horizont investimi prej t vitesh, investimi fillestar prej 100€ do të rritet në $100\text{€} * (1.06)^n$.
- Për një shkallë të interesit i dhe një kohëzgjatje prej n viteve, **vlera e ardhshme – K_n e investimit tuaj në vlerën fillestare K_0 , do të jetë:**

Llogaritja e interesit të përbërë



Interesi (kamata) i Përbërë

$$K_n = K_0 \left(1 + \frac{p}{100} \right)^n$$

K_n - Vlera e Ardhshme e Kapitalit

K_0 - Vlera e Tashme e Kapitalit

$$I = K_n - K_0$$




- Shohim se në shembullin tonë të ardhurat e interesit në vitin e parë kanë qenë 6€ (6 përqind e 100€) dhe në vitin e dytë ajo arrin në 6.36€ (6 përqind e 106€).
- Të ardhurat tonë në vitin e dytë janë më të larta sepse tani ne fitojmë interes edhe në 100€ e investuara fillimisht, edhe në 6€ e interesit, të fituara në vitin e kaluar.
- Fitimi i interesit në interes quhet **interesi i përbërë**.

Shembull 2:



1. Te llogaritet se me cfare perqindje duhet te depozitohen 100 euro per 2 vite me interes te perbere, qe te fitohen 110.25 euro.
2. Te llogaritet per sa vite duhet te deponohen 1750 euro me kamate 15% qe te fitohen 2314,375 nese kemi llogaritje te interesit te perbere.



Vlerat e ardhshme me interes të përbërë

Nga figura e mësipërme, mund të konkludohet si vijon:



- Sa më e madhe të jetë norma e interesit i (*perqindja*), aq më e madhe do të jetë vlera e ardhshme e shumës së investuar.
- Sa më e gjatë të jetë periudha e investimit (n), aq më e lartë do të jetë vlera e ardhshme



Shkalla vjetore e interesit

Numri i viteve	5%	6%	7%	8%	9%	10%
1	1,050	1,000	1,070	1,080	1,090	1,100
2	1,103	1,124	1,145	1,166	1,188	1,210
3	1,158	1,191	1,225	1,260	1,295	1,331
4	1,216	1,262	1,311	1,360	1,412	1,464
5	1,276	1,338	1,403	1,469	1,539	1,611
10	1,629	1,791	1,967	2,159	2,367	2,594
20	2,653	3,207	3,870	4,661	5,604	6,727
30	4,322	5,743	7,612	10,063	13,268	17,449

Vlera e ardhshme e 1€

Vlera e tanishme e një shume të ardhshme



- Paratë mund të investohen dhe mbi to të fitohet interes. Nëse na ofrohet zgjedhja ndërmjet 100,000€ tani dhe 100,000€ në fund të vitit, natyrshëm ne do t'i merrnim paratë tani për të fituar interesin vjetor.
- Menaxherët, financiarë kanë në mendje të njëjtën gjë kur thonë se paraja ne dorë tani ka një *vlerë kohore* ose kur ata e citojnë ndoshta parimin më elementar financiar:
- “Një euro sot është më i vlefshëm se një euro nesër.”



- Ne e pamë që 100€ të investuara për 1 vit me 6 përqind interes do të rriten në një vlerë të ardhshme prej $100 \times 1.06 = 106\text{€}$. Ta kthejmë të kundërtën: Sa para duhet t'i investojmë tani në mënyrë që të fitojmë 106€ në fund të vitit? Menaxherët këtë e quajnë si **vlerë të tanishme (VT) të 106€ që do t'i marrim.**
- Për të llogaritur vlerën e tanishme, thjesht e kthejmë mbrapsht procesin dhe e pjesëtojmë vlerën e ardhshme me 1.06:




- Investitori u jep vlerë më të madhe parave që disponon tani se sa atyre me të cilat do të disponojë në vitet e ardhshme, në saje të efekteve që do t'i nxjerrë nga investimi.
- Me një fjalë, investitori kërkon një çmim për sakrificën e tij dhe kjo paraqet preferencën e tij kohore mbi vlerën e parasë.





- Norma e diskontimit përcaktohet nga vetë investitori dhe ajo shpreh qëndrimin e tij ndaj efikasitetit që kërkon prej investimit. Sa më e lartë të caktohet kjo normë, kërkesa për efikasitet është më e madhe. Kërkojmë kompensim më të madh nga investimi.
- Mëgjithatë, ekzistojnë disa faktorë të cilët ndikojnë në lartësinë e normës diskontuese, si:
 - Oferta e burimeve financiare në tregun e kapitalit
 - Lartësia e interesit
 - Rreziku dhe pasiguria në investim
 - Politika makroekonomike
 - Politika afariste e ndërmarrjes.



Vlera e parasë gjatë kohës



- Nga figura e mësipërme, mund të konkludohet si vijon:
- • Vlera aktuale e një euroje varet nga zgjatja e kohës dhe norma e interesit;
- • Meqenëse vlera aktuale është më e vogël se sa vlera e ardhshme për nivelin e normës pozitive të interesit, faktori i vlerës së ardhshme $PVIF^{i,n}$ është gjithnjë më e vogël se 1.
- • Sa më e madhe të jetë norma e interesit i , *aq më e vogël do të jetë vlera e tanishme e shumës së ardhshme.*
- • Sa më e gjatë të jetë periudha e investimit (n), *aq më e ulët do të jetë vlera e tanishme e vlerës së ardhshme*



Shkalla vjetore e interesit

Numri i viteve	5%	6%	7%	8%	9%	10%
1	0,952	0,943	0,935	0,926	0,917	0,909
2	0,907	0,890	0,873	0,857	0,842	0,826
3	0,864	0,840	0,816	0,794	0,772	0,751
4	0,823	0,792	0,763	0,735	0,708	0,683
5	0,784	0,747	0,713	0,681	0,650	0,621
10	0,614	0,558	0,508	0,463	0,422	0,386
20	0,377	0,312	0,258	0,215	0,178	0,149
30	0,231	0,174	0,131	0,099	0,075	0,057

Vlera e tanishme e 1€